



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË

DEGA VENDORE TIRANË

NOTER ERMAL XH. HAMZAJ  
ADRESA Rruga: "Pashko Vasa", Pallati  
Nr.8, Shk.1, Zyra 5, Kt.2 Njesia  
Bashkiake Nr. 5  
TEL: 698227426

# KONTRATË DHURIMI PASURI E LUAJTSHME (KUOTA KAPITALI)

Nr. repertori: 3797

Nr. koleksioni: 2146

Tirane më 29/07/2021

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë"

\*Akti noterial përbëhet nga 16 fletë



A2021053150221683458

REPUBLIKA E SHQIPËRISE  
DHOMA KOMBETARE E NOTERISE  
DHOMA E NOTERISE TIRANË  
NOTER ERMAL XH.HAMZAJ  
Nr. 3789 Rep.  
Nr. 2473 Kol.

**KONTRATË DHURIMI  
KUOTASH**



Në Tiranë, sot në datën 29.07.2021 (dymijë e njëzetë e një), përpara meje noter Ermal Xh. Hamzaj, Anetar i Dhomes se Noterise Tirane, me license profesionale Nr.511, me zyre noteriale te ndodhur ne adresen Rr: "Pashko Vasa", Pallati Nr.8, Shk.1, Zyra 5, Kt.2 Njesia Bashkiake Nr. 5, u paraqitën personalisht palët me gjeneralitetet si më poshtë:

**Shoqeria "DM&S" SHPK**, shoqeri e se drejtes tregtare shqiptare, regjistruar ne QKB me date 22.11.2007, me NIPT K72322004L, e ndodhur ne Tirane, Njesia Bashkiake Nr. 13, Rruga "Kristo Luarasi", pallati prane Kopshtit Botanik, tek tre Kullat, Kulla 1, kati 1, Zona Kadastrale 8270, perfaqesuar nga Administratori **Znj. Voltisa Dervishi**, e datelindjes 19.07.1975, lindur ne Lushnje dhe banuese ne Tirane, shtetase Shqiptare, madhore, me zotesi te plote per te vepruar, mbajtese e Leternjoftimit me Nr. Personal H55719109], me poshte referuar si Dhuruesi:

dhe

**Shoqeria "CPM International" SHPK**, shoqeri e se drejtes tregtare shqiptare, regjistruar ne QKB me date 30.08.2016, me NIPT L62030012K, me seli ne Tirane, Njesia Bashkiake Nr. 5, Rruga Nikolla Tupe, Nderresa 4, Shkalla 3, Apartamenti 16, perfaqesuar nga Administratori **Z. Dritan Leka**, atesia Bujar, amësia Melita, i datelindjes 27.06.1986, i lindur ne Tirane dhe banues në Tirane, madhor, me zotesi te plote per te vepruar, mbajtes i leternjoftimit nr. Personal I60627019B., me poshte referuar si Dhuruesi:

**HYRJE**

*Duke konsideruar faktin se Shoqeria "DM&S" SHPK eshte ortak i shoqerise "Kapital-Parking" SHPK, shoqeri tregtare e te drejtes Shqiptare, e rregjistruar ne regjistrin tregtar ne daten 19.03.2021, me nipt Nr. M11519006M dhe zoteron 1 kuotë/pjesë, me vlere 50.000 leke (pesëdhjetë mijë leke), qe perfaqeson 50 % te kapitalit te saj,*

*Duke konsideruar faktin qe Dhuruesi, Shoqeria "DM&S" SHPK, deshiron ti dhuroj ortakut ekzistues Shoqerise "CPM International" SHPK, 1 kuotë/pjesë qe perfaqeson 1 % te kapitalit te shoqerise ne vleren 1.000 leke ( nje mije leke).*

*Duke konsideruar faktin qe Shoqeria "CPM International" SHPK deklarone se pranon dhurimin qe i behet nga Shoqeria "DM&S" SHPK, te 1 kuotë/pjesë, qe perfaqeson 1 % te kapitalit te shoqerise ne vleren 1.000 leke ( nje mije leke).*

Palët me vullnet të lirë dhe të plotë më kërkuan mua noterit redaktimin e kësaj kontratë dhurimi kuotash, me përmbajtje si më poshtë vijon :

**Neni 1**

**Qëllimi i kontratës**

1. Kjo kontratë shërben për përcaktimin e kriterëve, procedurave dhe mënyrës së transferimit të pronësisë së kuotave nga Dhuruesi, tek Pranuesi i Dhurimit.
2. Në përcaktim të kushteve, palet konsiderojnë të ligjshme përmbajtjen e saj dhe marrin persiper të ekzekutojnë veprimet e tyre brenda kushteve të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi.

## **Neni 2 Objekti i kontrates**

1. Objekti i kësaj kontrate është transferimi i pronësisë të 1 kuotë/pjesë, që përfaqëson 1 % të kapitalit të shoqërisë në vlerën 1.000 leke ( një mijë leke), nga Ortaku, Shoqëria "DM&S" SHPK, tek Ortaku ekzistues, Shoqëria "CPM International" SHPK.
2. Dhurimi i 1 kuotë/pjesë, që përfaqëson 1 % të kapitalit të shoqërisë, nga Dhuruesi, Shoqëria "DM&S" SHPK, tek Pranuesi i Dhurimit, Shoqëria "CPM International" SHPK do të behet pa kundershperblim, apo detyrim tjetër ligjor.

## **Neni 3 Pergjegjesite dhe garanci te dhuruesit**

- Dhuruesi, nepermjet kësaj kontrate, garanton Pranuesin e dhurimit si me poshte:
- a) se kuotat objekt dhurimi janë plotësisht të lira nga cdo barre, apo kufizim i mundshëm mbi to;
  - b) se miratimi për transferimin e këtyre kuotave në drejtim të pranuesit të dhurimit është marrë në pajtim të plotë me ligjin tregtar në fuqi nga organet vendimarrëse të dhuruesit;
  - c) i ka dhënë pranuesit të dhurimit cdo informacion të nevojshëm në lidhje me detyrimet e shoqërisë apo pretendime të paleve të treta;

## **Neni 4 Efektet e kontrates**



1. Kjo kontratë ka fuqinë e ligjit për palet nga momenti i nënshkrimit të saj.
2. Kontrata ka efekt për palet e treta në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

## **Neni 5 Informacioni konfidencial**

Palet detyrohen të mbajnë të fshehtë të gjithë dokumentacionin, të dhenat dhe cdo informacion tjetër të përfituar gjatë marrëdhënies së tyre në përputhje me këtë kontratë.

## **Neni 6 Transferimi i te drejtave**

1. Menjehere mbas nënshkrimit të paleve, kontrata do të regjistrohet në regjistrin tregtar për të bërë të mundur transferimin e kuotave në emër të Ortakut tjetër të shoqërisë.
2. Me nënshkrimin e kësaj kontrate, Dhuruesi Shoqëria "DM&S" SHPK zhvishet teresisht nga pronësia mbi 1 kuotë/pjesë që përfaqëson 1 % të kapitalit që zoteron në shoqërinë "Kapital-Parking" SHPK si dhe nga cdo e drejtë tjetër mbi këto kuote, dhe zotëruesi i saj behet Pranuesi i dhurimit, Shoqëria "CPM International" SHPK.
3. -Me nënshkrimin e kësaj kontrate, kapitali i shoqërisë do të zotërohet nga ortakët si me poshte vijon:
  - a) Ortaku Shoqëria "DM&S" SHPK do të zotëroj 1 kuotë që përfaqëson 49% të kapitalit të shoqërisë në vlerën 49.000 Leke.
  - b) Ortaku Shoqëria "CPM International" SHPK do të zotëroj 1 kuotë që përfaqëson 51% të kapitalit të shoqërisë në vlerën 51.000 Leke.



**Neni 7**  
**Interpretimi i kontrates**

1. Nese do te jete e nevojshme te behet interpretimi i kesaj kontrate, do te synohet te percaktohet se kush ka qene qellimi real dhe i perbashket i te dyja paleve, pa u mbeshtetur ne kuptimin literal te fjaleve, dhe gjithashtu duke vleresuar sjelljen e tyre ne teresi, perpara dhe pas perfundimit te kesaj kontrate.
2. Kushtet e kesaj kontrate do te interpretohen njera pas tjetres, duke dhene seicila kuptimin qe rrjedh nga teresia e kontrates ne fjale. Kontrata do te interpretohet ne konfidence nga palet.

**Neni 8**  
**Ligji i aplikueshem dhe Gjykata kompetente**

- 1 Kontrata eshte hartuar dhe interpretuar ne perputhje me ligjet e Republikes se Shqiperise dhe ligjet tregtare ne fuqi.
- 2 Dhuruesi dhe Pranuesi i dhurimit angazhohen te bejne cdo perpjekje te zgjidhin mosmarveshjet apo konfliktet e krijuara midis tyre, lidhur me kete kontrate nepermjet negociemeve te drejteperdrejta.
- 3 Nese palet deshtojne ne zgjidhjen e mosmarveshjeve apo konflikteve midis tyre, ato do ti drejtohen juridiksionit gjyqesor per zgjidhjen e tyre.


**Neni 9**  
**Dispozita perfundimtare**

- 1.Kjo kontrate eshte hartuar ne 3 (tre) kopje, ne gjuhen Shqipe, nga nje per secilen pale, e cila ju lexua me ze te larte e te qarte paleve te mesiperme nga une noteri.
- 2.Pas leximit, ato deklaruan perpara meje noterit se e kuptuan dhe pasi e gjeten kete akt ne perputhje me vullnetin e tyre, e nenshkruan kete akt perpara meje noterit pa asnje rezerve.
3. Mbas nenshkrimet te kesaj kontrate nga palet e mesiperme, une noteri e vertetova ate ne perputhje me ligjin "Mbi noterine" (i ndryshuar).

**PALET KONTRAKTORE**

**DHURUESI**


Shoqeria "DM&S" SHPK



A circular stamp for "DM&S" SHPK, Tirana, Albania, with the text "DISTRIBUCION" and "MARKETING & SERVICES". A handwritten signature is written over the stamp.

**PRANUESI I DHURIMIT**

Shoqeria "CPM International" SHPK



A circular stamp for "CPM International" SHPK, with the text "CPM International" and "WPT: L62030012K". A handwritten signature is written over the stamp.



A rectangular notary stamp with the text "NOTERI" and "ERNAL XHANA". A handwritten signature is written over the stamp.

Shoqeria "Kapital-Parking" SHPK  
NIPT:M11519006M  
Adresa: Tirane, Prane Kopshtit Zoologjik

VENDIM datë \_\_\_/\_\_\_/2021

I

### ASAMBLESE SË PËRGJITHSHME TË ORTAKËVE

Sot me date \_\_\_/\_\_\_/2021, u mbledh Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve të Shoqërisë "Kapital-Parking" Shpk në prezencë të të gjithë ortakëve të saj, për të diskutuar, shqyrtuar dhe vendosur me rendin e dritës si më poshtë:

- Transferimin nepermjet dhurimit të 1% të kuotes që ortaku ekzistues DM&S Shpk zoteron në shoqëri, të cilat perfaqesojnë në total 1% të kapitalit të shoqërisë, ortakut tjetër të shoqërisë CPM International Shpk.
- DM&S Shpk mbetet kështu me 49% të kapitalit në shoqëri
- CPM International Shpk mbetet me 51% të kapitalit në shoqëri

Pas një diskutimi të hollësishëm të pikave të mësipërme, të përfshira në rendin e ditës të asamblejës së përgjithshme të ortakëve:

### VENDOSI

- Miratimin e transferimit nepermjet dhurimit të 1% të kuotes që ortaku ekzistues DM&S Shpk zoteron në shoqëri, të cilat perfaqesojnë në total 1% të kapitalit të shoqërisë, ortakut tjetër të shoqërisë CPM International Shpk.
- DM&S Shpk mbetet kështu me 49% të kapitalit në shoqëri
- CPM International Shpk mbetet me 51% të kapitalit në shoqëri

Ngarkohet administratori i shoqërisë apo çdo person i autorizuar prej tij për depozitimin e vendimit në Regjistrin Tregtar të Qendrës Kombëtare të Biznesit si dhe kryerjen e çdo lloji veprimi pa kufizim për arritjen e qëllimit të mësipërm.

### ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E ORTAKËVE

Perfaqesuar nga

DM&S Shpk



CPM International Shpk



**RBS**  
**Regjistri i Barrëve Siguruese**

Rr. e Dibrës, Qendra e Biznesit AK,  
"Selvia", Kati V  
TIRANE, SHQIPERI  
TEL/FAX.:355 4 2420005  
TEL:355 4 2420006  
Email: rbs@roen-al.com

**REZULTATET E KËRKIMIT**

Numri i Rezultatit te Kerkimit: D-20210728162928382  
Data e Rezultatit te Kerkimit: 28.07.2021  
Ora e Rezultatit te Kerkimit: 4:29:28PM  
Lloji i Kerkimit:  
Numri i Dokumentit: D-400-113-1692  
Referenca e Perdoriesit:

**LISTA E PERSONAVE ME REZULTAT KERKIMI 0**

VOLTISA PETRIT DERVISHI  
DM & S K72322004L



*Judina Orkeaj*

